



Prishtinë: 02.09.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1394\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_2203\_06\_21 .

në seancën e mbajtur më datë 02.09.2021 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F.N, nga Prishtina si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij rekomandimi.

### A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) është parashtruar ankesa nga parashtruesi F.N me shifër **DPR – 90117739** me të cilën është kundërshtuar përgjigja e lëshuar nga KESCO lidhur me kontestimin e faturimit per periudhën janar dhe shkurt 2019.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 17.12.2018 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e pikës matëse ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.67445258 me gjendje TL=3991 kWh dhe TU=3965 kWh, si dhe kanë vendosur per matje grupin matës nr.40239882 me gjendje TL=00000,307 kWh dhe TU=00000,000 kWh, të energjisë reaktive TL=00000,238 kVar dhe TU=00000,000 kVar, si dhe gjendja momentale e Maxigrafit në TL=00000,000 dhe TU=00000,000, si dhe konstantja llogaritëse C=80.

**Provë:** Procesverbal mbi montimin-demontimin - ndërrimin e grupit matës nr.024255 i datës 17.12.2018

Me datë 20.02.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin e periudhës janar 2019 për shkak të dyshimit në faturimin jo të saktë.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit datë 20.02.2019

Me datë 27.02.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e pikës matëse ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve te evidentuara ne grupin matës nr.40239882 ku TL=174,35 kWh dhe TU=117,23 kWh, të energjisë reaktive TL=0.94 kVar dhe TU=0.40 kVar. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që gjatë kontrollimit të pikës matëse është evidentuar kjo gjendje: Njehsori në hyrje ka renditjen e duhur të tensioneve (L1, L2, L3) si dhe të rrymave në sistemet përkatëse matëse, TMRR-të janë verifikuar në matje si dhe konstantja llogaritëse 400/5A (C=80).

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin - pranimin e grupit matës nr.0070623 i datës 27.02.2019



Me datë 15.03.2019 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike, leximin nga distanca si dhe bazuar në raportin mbi kontrollimin - pranimin e grupit matës nr.0070623 i datës 27.02.2019.

**Provë:** Përgjigja e KESCO-s e datës 18.05.2018

Me datë 15.03.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO duke kundërshtuar faturimin nga periudha janar 2019 për shkak të dallimit në faturim.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 15.03.2019

Bordi i ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga konsumatori dhe KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 17.12.2018 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e pikës matëse ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.67445258 me gjendje TL=3991 kWh dhe TU=3965 kWh, si dhe kanë vendosur për matje grupin matës nr.40239882 me gjendje TL=00000,307 kWh dhe TU=00000,000 kWh, të energjisë reaktive TL=00000,238 kVar dhe TU=00000,000 kVar si dhe gjendja momentale e Maxigrafit në TL=00000,000 dhe TU=00000,000 si dhe konstantja llogaritëse C=80. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar se njehsori elektrik është vendosur për matje sipas PPE-së nr. 12831 datë 10.11.2017.

**Provë:** Procesverbali mbi montimin-demontimin - ndërrimin e grupit matës nr.024255 i datës 17.12.2018

Me datë 20.02.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin e periudhës janar 2019 për shkak të dyshimit në faturimin jo të saktë, si dhe ka kërkuar që t'i bëhet kontrollimi i njehsorit. Me datë 27.02.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e pikës matëse ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të evidentuara në Grupin matës nr.40239882 ku TL=174,35 kWh dhe TU=117,23 kWh, të energjisë reaktive TL=0.94 kVar dhe TU=0.40 kVar. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që gjatë kontrollimit të pikës matëse është evidentuar kjo gjendje: Njehsori në hyrje ka renditjen e duhur të tensioneve (L1, L2, L3), si dhe të rrymave në sistemet përkatëse matëse, TMRR-të janë verifikuar në matje, si dhe konstantja llogaritëse 400/5A (C=80). Bazuar në shpenzimet e evidentuara dhe faturuara në CCP, DMK konstaton se faturimi i periudhës janar dhe shkurt 2019 plotësisht përputhet me shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KESCO e datës 20.02.2019 dhe raporti mbi kontrollimin - pranimin e grupit matës nr.0070623 i datës 27.02.2019

Bazuar në analizën e bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori ka lexim të rregullt të pikës matëse. Sipas analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori me njehsorin elektrik nr.67445258 energjinë aktive ka pasur të llogaritur me konstante llogaritëse C=1 pasi që ka qenë njehsor me matje direkte, kurse nga periudha 17.12.2018 bazuar në PEE nr.12831 të datës 10.11.2017 me vendosjen e grupit matës nr.40239882 konsumatori ka konstantën llogaritëse C=80, si dhe ka të ndërruar grupin tarifor përkatësisht është ndërruar kategoria e konsumatorit nga 7/02 komercial në 6/6 e ku përfshihet edhe llogaritja e fuqisë së angazhuar bazuar në shpenzimet e krijuara.

**Provë:** Rrjedha e energjisë elektrike dhe transaksionet

KEDS ka ofruar Pëlqimin elektroenergjetik nr. 12831 datë 10.11.2017 i cili i është lëshuar konsumatorit Faton Nishevc, "F-SHPED" SH.P.K me adresë në fshatin "Llapanasellë", komuna e Garancisë me të cilën vërtetohet se matja e energjisë së shpenzuar do të bëhet përmes njehsorit elektrik multifunksional (aktive, reaktive dhe maxigraf), 3x230/400V, 5A, me grup tarifor 6/6 përmes transformatorëve rrymor (TMRR) me koeficient të transformimit 400/5 A/A përkatësisht konstantja llogaritëse duhet të jetë C=80. Po ashtu është dorëzuar edhe raporti teknik nr.4128 i datës 14.05.2018 me të cilin vërtetohet se



ekipet e KEDS-it per pranime teknike kanë bërë pranimin teknik të instalimeve të ndërtuar nga konsumatori Faton Nishevci i cili po të njëjtën dite ka bërë kërkesë edhe për njehsorin elektrik me qëllim të energjizimit. Pra, bazuar në këto shkresa të lëndës konstaton se konsumatori nga periudha 12/2018 ka bërë ndërrimin e grupit tarifor nga 7/02 në grupin tarifor 6/6 që do të thotë se tani konsumatori faturohet sipas shpenzimeve të regjistruara në grupin matës.

**Provë:** Pëlqimin elektroenergjetik nr.12831 i datës 10.11.2017, raporti teknik nr.4128 i datës 14.05.2018 si dhe kërkesa e konsumatorit per njehsorë

Në nenin 28, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji theksohet se: 1. *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar e dhe për tarifën tjerë, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”* dhe 2. *Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit dhe që duhet theksuar se në rastin e konsumatorit në fjalë, Furnizuesi ka respektuar dy nenet e përmendura me lartë*

Bordi i ZRRE bazuar në të gjitha shkresat, e veçanërisht bazuar rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe transaksionet e konsumatorit, procesverballi mbi montimin-demontimin - ndërrimin e grupit matës nr.024255 i datës 17.12.2018, raporti mbi kontrollimin - pranimin e grupit matës nr.0070623 i datës 27.02.2019, si dhe respektimin e nenit 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji konstaton se për periudhën kontestuese konsumatori ka lexime dhe faturime te sakta te shpenzimeve te regjistruara ne Grupin matës dhe nuk i takon korrigjim.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Gashi, anëtar

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit: F.N
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.